

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"STEISI TAXI" SHPK.**

Sot, në Tiranë, më 01/04/2024 bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **"STEISI TAXI" SHPK.**

Unë ortaku i vetëm Flor Lushi, i biri i Pashkut, i datëlindjës 16/05/1983, lindur në Fushe Arrëz dhe banues në Tiranë në adresën: "Rruga Leonard Frroku " i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr. 038963761 dhe me numër personal I30516038H, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare "STEISI TAXI" SHPK, e cila do të nënshkruhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare "STEISI TAXI" SHPK do të jetë në adresën: "Leonard Frroku, Nd. 40; H. 1, Njesia Bashkiake nr. 6,1027, Tirane"

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt:  
1-Shërbim Taksi 4+1 brenda dhe jashtë teritorit të vendit

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

**Neni 6**



Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.500.000 leke (Nje milion e peseqind mije), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "STEISI TAXI" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Flor Lushi. për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

### Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### Neni 10

Shoqëria tregtare "STEISI TAXI" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### Neni 11

Shoqëria tregtare "STEISI TAXI" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar në të gjitha kopjet.

## THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"STEISI TAXI" SHPK

ORTAKU I VETËM

Flor Lushi

